



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

**V E N D I M**

**Nr.2556, datë 10.04.2015**

**Për**

**Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Tel-Kom sh.p.k., kundër masës administrative të dënimit me Gjobë.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj.Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj.Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 10.04.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Shqyrtimi i ankimit administrativ të sipërmarrësit Tel-Kom sh.p.k., kundër masës administrative të dënimit me Gjobë.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar;
2. Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (ligji nr. 8485), i ndryshuar;

3. Rregullore e AKEP nr.1516 datë 31.01.2011 “Për Inspektimin e veprimtarisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe kundravajtjet administrative”;

## K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa nr. 730Prot. datë 10.3.2015, (nr. 437/4 Prot. i AKEP, datë 11.3.2015), “Ankimim” të sipërmarrësit Tel - Kom sh.p.k.
2. Urdhri i Inspektimit nr. 437Prot, datë 17.2.2015; Akti i Inspektimit me nr. 437/1Prot, datë 27.2.2015; Gjoha nr. 20, datë 27.2.2015, dhe dokumentacioni bashkëngjitur kësaj praktike inspektimi;
3. Kontratat e pajtimtarit nr. 817 dhe nr. 818, për shërbimin publik telefonik të qëndrueshëm, (vënë në dispozicion nga përfaqësuesi i sipërmarrësit gjatë inspektimit);
4. Korrespondenca me postë elektronike e shkëmbyer mes palëve (njoftim me SMS);
5. Akti i inspektimit nr. 700/2Prot., datë 17.4.2013.
6. Relacion shpjegues (Relacioni);

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

### I.

1. Sipërmarrësi Tel-Kom sh.p.k. me anë të ankimit nr. 730Prot, datë 10.3.2015, shpjegon se nga inspektimi i kryer në ambientet e tij, më datë 27.2.2015, kanë dalë këto probleme për sa i takon:
  - Kontratës së pajtimtarit për shërbimin e telefonisë fikse dhe shërbimin internet, që sipërmarrësi aplikon;
  - Funkcionimit të faqes së internetit të sipërmarrësit me domain: [www.tel-kom.al](http://www.tel-kom.al), ku duhet të pasqyrohen kërkesat e rregullove të AKEP.

Lidhur me problemet e konstatuara të kontratës me pajtimtarin, Tel-Kom sh.p.k., shprehet se ndryshimet e kërkuara sipas rregullores nr. 26.12.2013, janë pasqyruar dhe kontratat janë rregull, por inspektorëve mund t’u jenë dorëzuar kontratat e mëparshme.

Për mosfunksionimin e faqes së internetit, Tel-Kom sh.p.k. shpjegon se, i ka njoftuar inspektorët se gjatë kësaj kohe, kanë qenë duke ndryshuar hostimin dhe faqja do të jetë e padisponueshme sa të zgjidhen problemet teknike.

*Në përfundim*, sipërmarrësi, i kërkon Këshillit Drejtues të AKEP, se meqënëse ky operator nuk ka patur probleme gjatë inspektimeve në vite, sa i takon zbatimin të detyrimeve rregullatore, të rishikojë gjobën.

## II.

1. Lidhur me procesin e inspektimit, nga shqyrtimi i materialeve të dosjes së inspektimit (*Akt Inspektimi nr. 437/1Prot., datë 27.2.2015 dhe Relacioni nr. 436/2Prot., datë 4.3.2015*), vërehet se, me Urdhrin e Inspektimit nr. 437Prot., datë 17.2.2015, Kryetari ka udhëruar kryerjen e inspektimit në sipërmarrësin e komunikimeve elektronike Tel-Kom sh.p.k., me objekt verifikimin e zbatimit të:
  - Kushteve të autorizimit të përgjithshëm;
  - Rregullores për “Për portabilitetin e numrit”;
  - Rregullores për “Caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike”;
  - Rregullores për “Administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar dhe ndërkombëtar për interkoneksin e rrjeteve”;
  - Rregullores mbi “Dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave”;
  - Rregullores “Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve”;
  - Konformitetit të pajisjeve dhe aparaturave, sipas Rregullores nr. 25, datë 14.6.2012;
  - Rregullores “Për treguesit e cilësisë së shërbimit”;
  - Rregullores “Për kushtet e përdorimit të frekuencave pa autorizim individual dhe kërkesat teknike për pajisjet që përdoren në këto breza”;
  - Rregullores për “Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve në RSH”;
2. Në zbatim të udhrit të lartpërmendur Grupi i Inspektimit, ka njoftuar përfaqësuesin ligjor të Tel-Kom sh.p.k., znj. Vjolanda Prifti, për kryerjen e inspektimit dhe e ka njohur me Urdhrin nr. 437, datë 17.2.2015, duke i kërkuar krijimin e kushteve për kryerjen e inspektimit konform nenit 12, të Rregullores nr. 34, datë 23.12.2014 për “Inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative”.
3. Grupi i inspektimit, gjatë kryerjes së inspektimit u shoqërua nga përfaqësuesja ligjore. Në përfundim të verifikimit të zbatimit të detyrimeve të sipërmarrësit dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga sipërmarrësi, grupi i inspektimit ka konstatuar se:

Sipërmarrësi Tel-Kom sh.p.k. sipas Autorizimit Nr. 2012-AP-U189-8-2, ofron:

- Rrjete publike tokësore fikse (akses dhe transmetim)
- Shërbime publike të komunikimeve elektronike (1. Shërbime telefonike; 2. Shërbime të linjave me qira; 3. Shërbime të te tjera-aksesi në internet).

**Mbulimi me rrjet:** Tel-Kom sh.p.k., ofron shërbimin telefonik fiks në rrethin Tiranë për 100 përdorues familjarë, dhe 210 përdorues interneti familjarë.

**Standardet / miratimit të tipit:** sipas deklaratës së sipërmarrësit, pajisjet e përdorura ishin të pajisura me deklaratë konformiteti.

**Tarifat:** lidhur me këtë pikë, grupi i inspektimit ka marrë deklarin nga përfaqësuesi i sipërmarrësit se, tarifat e shërbimeve bazë dhe të instalimit aplikohen të unifikuara për të gjithë përdoruesit. Këto janë të njëjta me ato të publikuara kur faqja ishte e aksesueshme.

**Faturimi:** përdoruesit pajisen me faturë mujore të detajuar për shërbimin telefonik fiks.

**Shërbimet e urgjencës:** sipërmarrësi ka implementuar numrat e shkurtuar të emergjencës: 127, 128 e 129.

**Shërbimet urbane/ndërrurbane:** sipas deklaratës së përfaqësuesit realizohen përmes sipërmarrësit Albtelecom sh.a. me të cilin ka lidhur Marrëveshje Interkoneksioni.

**Kontrata me pajtimtarët:** grupi i inspektimit ka konstatuar se kontrata me pajtimtarët që sipërmarrësi ka aplikuar, nuk është në përputhje me Rregulloren nr. 31, datë 26.12.2013 “Për termat e përgjithshme të kontratës së pajtimit për lidhjen dhe aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike”.

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve:** sipas deklaratës së përfaqësuesit, nuk ka patur mosmarrëveshje. Ankesat janë zgjidhur brenda një kohe të shkurtër.

**Pajisjet e deklaruara:** Lan Desing, Data-Comm Network (connection map) sipas skemës teknike.

**Centrali telefonik:** i tipit ‘Telesis XI’; DSLAM /model Minerva/Modem ADSL –TPLink (për shërbimin internet).

Të dhënat e centralit:

komuna Bradashesh, kapaciteti 2000 numra, të instaluar: 500 numra, të lidhur 100 numra; kapaciteti i rrjetit I: 1200 linja.

**Numeracioni:** sipërmarrësi ka të implementuar kodin e drejtimit kombëtar NDC dhe bllokun e numrave SN, në përputhje me autorizimin.

**Treguesit e cilësisë së shërbimit:** sipërmarrësi nuk ka zbatuar pikën 1, të nenit 11, të Rregullores nr. 16, datë 16.4.2010, për matjen e treguesve të cilësisë. Sipërmarrësi nuk ka përgatitur manualin brenda afateve të parashikuara nga kjo rregullore në nenin 7/1.

**Publikimi i informacionit:** Grupi i inspektimit ka konstatuar se, faqja e internetit të sipërmarrësit, nuk ishte e aksesueshme, por nga përfaqësuesi është deklaruar se ka kryer publikimin konform Rregullores nr. 27, datë 21.9.2012. Në lidhje me këtë detyrim sipërmarrësit janë njoftuar zyrtarisht nga AKEP.

**Kryerja e pagesave në AKEP:** gjatë verifikimit, nga inspektorët e AKEP sipërmarrësit Tel-Kom sh.p.k. i është kërkuar shlyerja e detyrimeve ndaj AKEP.

**Të dhënat statistikore/financiare:** nga verifikimi u konstatua se sipërmarrësi nuk ka përbushur detyrimet e Rregullores nr. 12, datë 7.4.2010, për të dhënat statistikore dhe financiare.

4. Pas verifikimeve të lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga përfaqësuesi i sipërmarrësit Tel-Kom sh.p.k., grupi i inspektimit, ka konkluduar se:

1. Kontrata e pajtimtarit nr. 818, për ofrimin e shërbimit telefonik publik të qëndrueshëm, dhe Kontrata e pajtimtarit nr. 817, për ofrimin e shërbimit të aksesit në internet, që ky sipërmarrës lidh me pajtimtarët, nuk janë në përputhje me Rregulloren nr. 31, datë 26.12.2013, për “Termat e përgjithshme të kontratës së pajtimit për lidhjen dhe aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike”.

Sa më lart, sipas përcaktimeve të nenit 137, të ligjit nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe në përputhje me Rregulloren nr. 34, datë 23.12.2014 “Për inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative”, sipërmarrësi Tel-kom sh.p.k. duke moszbatuar nenin 99/1, ka konsumuar nenin 135/1, për kundravajtjet administrative, të ligjit 9918/2008 i ndryshuar.

- Për shkelje të nenit 99/1, dhe Rregullores nr. 34, datë 23.12.2014, grupi i inspektimit, në zbatim të nenit 137, paragrafi V, pika 5, ka vendosur dënimin me gjobë në vlerën 200 000 (dyqind mijë) Lekë, të sipërmarrësit Tel-Kom sh.p.k.
  - Sipërmarrësit i'u la detyrë të fillojë pajisjen me kontrata të pajtimtarëve konform rregullores nr. 31, datë 26.12.2013, me të gjithë elementët e kërkuar në nenin 99/1, të ligjit nr. 9918/2008 i ndryshuar, brenda datës 15.3.2015.
2. Për shkeljet e tjera të konstatuara, sipërmarrësit Tel-Kom sh.p.k., i lihet afat deri më datë 31.3.2015 për përmbushjen e detyrave si më poshtë:
- Të vërë në funksion menjëherë Faqjen e internetit të Tel-Kom sh.p.k., në përputhje me Rregulloren nr. 27, datë 21.9.2012, “Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve”.
  - Të publikojë informacionin konform Rregullores nr. 27, datë 21.9.2012. Rregullores “Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve”;
  - Të përmbushë detyrimet e rregullores nr. detyrimet e Rregullores nr. 12, datë 7.4.2010, për të dhënat statistikore dhe financiare.
  - Të përmbushë detyrimet sipas nenit 11, pika 1, të Rregullores “Për treguesit e cilësisë së shërbimit”;

### III.

DSHLMP dhe DMFCI, pasi shqyrtuan: (1) pretendimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga sipërmarrësi Tel-Kom sh.p.k., dhe (2) aktet në dosjen e inspektimit të hartuara dhe të mbledhura nga Grupi i Inspektimit, vlerëson se:

1. Ankimi i paraqitur nga Tel-Kom sh.p.k. me nr. 730Prot. datë 10.3.2015, protokolluar në AKEP me nr. 437/4 Prot., datë 11.3.2015, është kryer brenda afatit 10 ditor të parashikuar nga Rregullorja nr. nr. 34, datë 23.12.2014 “Për inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative”, dhe është në përputhje me formën e kërkuar ligjore;
2. Grupi i inspektimit në zbatim të parashikimeve të Rregullores nr. 34, datë 23.12.2015, për inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative” ka kryer veprimet proceduriale duke zhvilluar procedure inspektuese;

Rezulton se, Grupi i inspektimit ka njoftuar paraprakisht përfaqësuesin e sipërmarrësit dhe i ka dorëzuar kopjen e urdhrit nr. 437Prot., datë 17.2.2015. Nga ana e përfaqësuesve të sipërmarrësit, grupit të inspektimit i është vënë në dispozicion materiali i kërkuar. Në vijim, të procesit të inspektimit, përfaqësuesja ligjore e sipërmarrësit ka qenë prezent.

3. Për shkeljen e kryer nga Tel-Kom sh.p.k. për të cilën është ndëshkuar me masën e dënimit me “Gjobë”, konstatohet se sipërmarrësi, nuk ka pasqyruar në kontratën me pajtimitarin (*si për shërbimin e telefonisë fikse ashtu edhe për shërbimin e internetit*), mënyrën dhe procedurat për zgjidhjen e ankesave të pajtimitarit sipas pikës 99, pika 1/ë, në zbatim të ndryshimeve të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012.

Në këto procedura, duhet të ishte parashikuar në kontratë, e drejta e pajtimitarit për t’ju drejtuar AKEP-it, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me sipërmarrësin, (si një procedurë e thjeshtë e shpejtë e pa kosto për zgjidhjen e mosmarrëveshjes), përpara se t’i drejtohet gjykatës, sipas kërkesave të:

1. Nenit 107, i Ligjit nr. 9918/2008, “për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 102/20012.

2. Rregullores nr. 31, datë 26.12.2013, “Për termat e përgjithshme të kontratës së pajtimit për lidhjen dhe aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike”, pika VIII, nënpika 7, mbi trajtimin e ankesave.

Referuar edhe nenit 99/5 të ligjit nr. 9918/2008, sipërmarrësit kanë detyrimin e hartimit të kontratës me pajtimitarit mbi bazën e legjislacionit në fuqi, dhe rregullave të nxjerra nga AKEP në zbatim të tij.

Theksojmë se, në lidhje me këtë konstatim të shkeljes, ndryshe nga sa shprehet në ankim, sipërmarrësi është i qartë sepse i ka referuar me saktësi ndryshimet që duhen reflektuar në kontratë, në paragrafin e fundit të faqes nr. 3, të pretendimeve të paraqitura.

Në lidhje me këtë shkelje, inspektorët, veç dënimit me gjobë, i kanë lënë detyrë sipërmarrësit që brenda datës 15.3.2015, të pajisë pajtimitarët me kontrata të cilat duhet të jenë në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator si më lart përmendur.

4. Në lidhje me shkeljet e tjera të konstatuara, sipërmarrësit Tel-Kom sh.p.k., i është lënë afat deri më datë 31.3.2015 për përmbushjen e detyrimeve, konform parashikimeve të nenit 13, të Rregullores nr. 34, datë 23.12.2014 (*renditur në pikën II/4/2 të këtij relacioni*).
5. Në historikun e këtij sipërmarrësi, vërehet se, nga inspektimi i kryer në prill të vitit 2013, Tel-Kom sh.p.k. është dënuar me masën administrative ‘Gjobë’ në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) Lekë, për moszbatim të nenit 99/1, të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar.
6. Pas shqyrtimit të pretendimeve të sipërmarrësit Tel-Kom sh.p.k., arsytetimeve dhe akteve të paraqitura nga Grupi i Inspektimit, dhe nga analiza e plotë e çështjes objekt shqyrtimi, arsyetojmë se, vendosja e masës administrative “Gjobë” (nr. 20, datë 27.2.2015) përlligjet administrativisht pasi është e bazuar në dispozitat materiale dhe proceduriale të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar dhe Rregullores nr. 34, datë 23.12.2014, “Për inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative”

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe në pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918/2008 i ndryshuar, dhe në nenin 146/ a, të Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Drejtues i AKEP,

### V E N D O S:

1. Lënien në fuqi të masës administrative Gjobë me nr. 20, datë 27.2.2015, të vendosur nga Grupi i Inspektimit dhe rrëzimin e ankimit të paraqitur me shkresën nr. 730Prot., datë 10.3.2015, të sipërmarrësit Tel-Kom sh.p.k.
2. Të njoftohet sipërmarrësi Tel-Kom sh.p.k. për zbatimin e këtij Vendimi;
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Tiranës, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

### ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Anila DENAJ**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**